



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2018



Komuna e Kaçanikut

### Procesverbal

#### Takimi i II-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2018

Më 20.04.2018

Në takim prezantuan:

**Besim Ilazi**, Kryetarë i Komunës

**Afrim Halili** Komandant i Policisë-Kaçanik

**Ali Vishi**, përfaqësues i FSK-së

**Kjani Sallahu**, (mediet, OJQ-të, zejtarët, PAK-të)

**Fatmir Qaka**,EVSB

**Ramadush Osmani**-Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

**Lirije Luta**- Komiteti për Komunitete

**Zahir Doda**- Drejtor i DAK

**Fadil Guri**- Zyra për Kthim e Komunitete

**Vedat Dema**- Zyra për Barazi Gjinore

**Jashar Selimi**- Këshilli i Prindërve

**Menduh Rexha**-Bashkësia Islame

**Erblina Murseli**-(KLSP)

Monitorues nga OSBE i pranishëm ishte z. Shpetim Halilaj

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut z. **Besim Ilazi** dhe propozoi këtë rend dite:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar
- 2.Aktivitetet kundërligjore në projektin e autostradës , në pjesën e komunës së Kaçanikut.
- 3.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut
- 4.Informatë rrëth trajtimit të rekondimeve nga takimet e KKSB
- 5.Të ndryshme

### **1. Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar**

- Procesverbal u miratua nga të pranishmit

### **2. Aktivitetet kundërligjore në projektin e autostradës , në pjesën e komunës së Kaçanikut.**

-Të ftuar për të diskutuar rrëth kësaj pike është paraparë të ftohen edhe përfajqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe përfaqësues të Bechtelenkës. Sipas **Kryetarit** ata janë ftuar por që nuk u janë përgjigjur ftesës. Javën që vjen në zyrën time do të kem takim me këta përfaqësues dhe do ua përcjelli shqetësimet.

- **Kjani Sallahu:** Konsideroj se ata të Bechtel-Enka-s dhe të Ministrisë së Infrastrukturës, qëllimi i janë duke i ikur takimit me KKSB-në, për t'iu shmangur reagimit real të të qytetarëve. Për zgjidhjen e këtij problemi, ne kemi bërë punën tonë dhe se është problemi i tyre a dëshirojnë apo jo të janë pjesë e zgjidhjes së këtij problemi. Tek e fundit, qytetarët janë të komunës së Kaçanikut, fenomeni i vjedhjeve është në territorin e komunës së Kaçanikut, dhe është Komuna e Kaçanikut ajo e cila duhet të insistojë për sigurinë e tashme dhe të ardhme të qytetarëve të saj.

### **3. Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut**

-Rreth kësaj pike Komandanti i Stacionit të Policisë z.**Afrim Halili** tha se gjendja e sigurisë në përgjithsi është e qetë dhe stabile dhe nuk ka indikacione për të ardhmën për ndonjë prishje të rendit dhe sigurisë publike. Dukuria e vjedhjes dhe kanosjes kan qenë prezente në punimet që janë duke u zhvilluar në autostradë por që nuk ka rrezikuar sigurinë e përgjithshme.Kjo dukuri është një potencial që në të ardhmën mundë të na kushtoj por që do të angazhohemi që kësaj dukurie të ia ndalim hovin.

Dukuria e drogave nëpër shkolla është një shqetsim për të gjithë ne por që falë bashkpunimit të mirë që kemi me drejtoret e shkollave ne kemi ndërmarrë disa aktivitete vetdijuese për parandalimin e kësaj dukurie.

Jemi në përpilim të planit operativ për sezonin e verës ku jemi duke marrë masa dhe duke bërë planifikime të ndryshme për parandalimin e disa dukurive siq janë gjuajtja me armë zjarri nëpër darsma , parkingjet ilegale , masa për parandalimin e zjarreve dhe shum dukuri tjera që prishin rendin dhe qetësinë publike të qytetarëve

**Kjani Sallahu:** Kanosjet dhe armëmbajtjet pa leje, a janë mbrenda punishtes së autostradës apo është ndonjë pistë jashtë sajë.

**Komandanti i Policisë:**këto dukuri janë duke ardhur në shprehje kryesisht në këto punime.Ne jemi në teren dhe po e vëzhgojmë situatën me qëllim që të pengojmë qdo dukuri devijante.

**Kjani Sallahu:** Më bëri përshtypje ajo që u tha nga një parafolës se, nuk është cenuar siguria publike, ndërsa në anën tjetër u tha se ka pasur kanosje, vjedhje dhe armëmbajtje pa leje, e që sipas mendimit tim është shumë shqetësuese.

**Lirije Luta:** Sa mirret për bazë bashkpunimi me qytetarë gjat hartimit të planit operativ dhe si ka qenë bashkpunimi gjat kërkimit të një personi të humbur në fshati Shtrazë dhe a ka diqka rreth këtij kërkimi.

**Komandanti i Policisë:** Bashkëpunimi me qytetarë gjithmonë ka qenë i mirë dhe falë këtij bashkpunimi jemi ndër komunat më të qeta.Për personin e humbur në fshati Shtrazë kemi pasur aktivitet kërkimi dhe kërkimet ende vazhdojnë por deri më tanë nuk kemi gjetur gjurmë.Ka informacione se është parë në Han të Elezit dhe mundë të ishtë larguar në Maqedoni.

**Ramadush Osmani:**personate kapur me lëndë narkotike më intereson të dijë se a janë përdorues apo janë shpërndarës.

**Komandanti i Policisë:**ka persona edhe që përdorin po edhe që shpërndajnë.Ne këta persona ua përcjellim njësitit rajonal për antidrogë.

#### **4. Informatë rreth trajtimit të rekondimeve nga takimet e KKSB**

**Kjani Sallahu:** Ne po paraqesim probleme të përsëritshme, e nuk po raportojmë për probleme që janë zgjidhur. P.sh., kohën të fundit kemi vërejtur se shpejtësia e trenit në qytet është ngadalësuar, ndonëse laurat dhe sinjalistika në disa kalime mbi hekurudhë ende mungojnë. Ideja është se, tash nuk kemi nevojë ta shtrojmë si problem shpejtësinë e trenit, por duhet të merremi vetëm me laurat dhe sinjalistikën. Duhet ta dimë secilin problem që e kemi zgjidhur, që mos ta trajtojmë më. Rekomandimet që dalin nga takimet e KKSB-së, të mirren parasyshë. Nga Komuna është bërë një raport i mirë në lidhje me vërvshimet dhe shembjet e dheut në disa rrugë, por që nuk dimë se a është intrvenuar për

sanimin e gjendjes. Neve na intereson siguria e qytetarëve, përkatësisht intervenimi - investimi në projekte të sigurisë.

**Kryetari:** me kapacitetet që kemi në dispozicion jemi munduar të sanojmë gjendjen aty ku ka qenë më emergjente por që dëmet janë jashtzakonishtë të mëdha dhe ne u kemi dërguar kërkesë nivelistë qendrorë për të na dalë në ndihmë.

## 5.Të ndryshme

-**Erblina Murseli** prezentoit në kët takim dhe njoftoi se ka autorizim nga Koordinatorja e KLSP-së që të marrë pjesë në mbledhjet e KKSBS-së.

**Kryetari:** autorizimi duhet të jet si një vendim i marrur nga anëtarët e kuvendit të KLSP-së dhe të dërgohet në Kuvend Komunal për miratim.

**Fadil Guri:** qdo ndryshim që bëhet mbrenda strukturës së KKSBS-së duhet të dërgohet në Kuvend Komunal për miratim.

**Komandanti i Policisë:** pasi që KLSP-të janë në kuadër të Policisë së Kosovës , unë do të mirrem me kët qështje dhe do të përzgjedhim përfajqsuesin që do të përfajqsojë në KKSBS.

**Ali Vishi:** Kjo qështje është pak sa e ndërlikuar. Mendoj se gjatë themelimit të KKSBS-së është dashtë që përfajqsuesit e akterëve në KKSBS të kenë edhe nga një zëvendësues ngase është e pamundur që qdo herë të prezantojë përfajqsuesi në të gjitha takimet.

**Kjani Sallahu:** Lista e anëtarëve të KKSBS-së është dashtë të dërgohet në Kuvend Komunal vetëm si përfajqësim i subjektit, ngase për çdo ndryshim që bëhet në emra dhe në secilin rast të ndryshimeve eventuale, duhet të dërgohet në Kuvend për miratim.

**Komandanti i Policisë:** Policët e shtrirë në disa vende janë dëmtuar e sidomos në rrugën kryesore të fshatit Ivajë dhe është mirë të intervenohet në riparimin e tyre ngase janë të domosdoshme në pjesët ku ka qarkullim të vazhdueshëm të njerëzve dhe automjeteve.

**Kryetari:** kët punë e kemi bërë në vazhdimsi por që nevojitet një vetdijsim i qytetarëve për mos dëmtimin e këtyre barrierave.

**Kjani Sallahu:** Pajtohem me komendantin se, barrierat duhet të jenë në ato vende që është e nevojshme dhe nuk duhet pyetur askush për këtë punë. Siguria duhet të jetë mbi çdo prioritet dhe për këtë nuk duhet të vijnë në shprehje dëshirat apo shijet.

**Fatmir Qaka:** më intereson të dijë që ndërtimet e larta a posedojnë shkallë emergjente dhe a ju kushtëzohet marrja e leje ndërtimit nga Komuna kompanive që mirren me kët punë , si dhe sa janë të pajisur institucionet me aparate kundër fikjes së zjarrit. Mendoj se duhet bërë një hulumtim rrëth këtyre dy qështjeve.

**Kjani Sallahu:** Udhëzimi administrativ e parasheh që procesverbalet të publikohen në uebfaqen e Komunës, por kjo gjë deri më tani nuk është bërë. Nuk është e mjaftueshme të jepet vetëm si informatë në rrjetin social "Facebook" se çka është diskutuar në takimet e KKSBS-së, sepse edhe ashtu informata është totalisht e njëanshme. Pra, aty prezantohet vetëm se çfarë tha kryetari dhe kamandanti, por jo edhe çfarë tham ne që po i ngrisim pothuaj të gjitha shqetësimet dhe problemet e sigurisë me të cilat përballen qytetarët.

#### **REKOMANDIMET:**

1. Çështjet që cënojnë sigurinë e qytetarëve të zgjidhen, e mos të përsëriten në çdo takim.
2. Të investohet në projekte që lidhen me sigurinë e qytetarëve
3. Të definohet çështja e përfaqësimit në KKSBS
4. Ndërtimet e larta të kenë shkallë emergjente dhe kjo të kushtëzohet me dhënjen e lejes për ndërtim
5. Të hulumtohen të gjitha objektet institucionale rreth asaj se a posedojnë aparate përfikjen e zjarreve
6. Procesverbali i takimeve të KKSBS-së të publikohet në uebfaqen e Komunës së Kaçanikut
7. Të vendosen policë të shtrirë kudo ku vlerësohen të nevojshme, pavarësisht reagimeve të qytetarëve

Pas këtyre rekomandimeve Kryetari përmbylli takimin përtu takuar në mbledhjen e radhës.

Kaçanik 20.04.2018

Kryesuesi:

Kryetari i Komunës

z.Besim Ilazi



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka